
	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	
---	--	---

Datë/a:	27.03.2023.
Për/ Za/ To:	Operatori Ekonomik: EKO DDD
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Visar Shehu – U.D. i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës **26.03.2023** të parashtruar nga Operatori Ekonomik: EKO DDD SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor”**, me Nr. të Prok: **616-22-83-2-1-1** nxjerr:

V E N D I M

1. **HUDHET POSHTË SI E PALEJUAR** kërkesa për ri shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: : EKO DDD SH.P.K. e parashtruar me datë: 15.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor”**, me Nr. të Prok: **616-22-83-2-1-1**, kundër **Njoftimit për Kontratë**, të datës **28.09.2022** të publikuar ne web-faqe te KRPP-së , në bazë të nenit 108/A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.
2. **Kërkesa për Rishqyrtim është në kundërshtim me nenin 108/A për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim – (tërë pretendimet ankimore janë të sqaruara me vendime paraprake dhe me dosjen e korrigjuar sipas vendimit të OSHP-së me nr. 639-640) – (RES JUDICATA)**
3. Autoriteti Kontraktues, mbështet vendimin për të vazhduar lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Deratizimi për nevojat e kujdesit shëndetësor”**, me Nr. të Prok: **616-22-83-2-1-1**
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>